



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E GJASHTË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **20.07.2022 (e Mërkurë)** në zyrën e konferencave të objektit e vjetër të Komunës së Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Illir Zuka, z.Ramadan Deliu, znj.Zejnepe Osmani,znj. Liridona Bislimi. Munguan z.Jakup Demiri, znj.Zyrafete Rama. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se prezent janë 5 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Bekim Azizi: Përshëndetje për të gjithë ju anëtarë të KPF-së, nënkryetar, drejtorët që janë prezent në këtë mbledhje, mirë se keni ardhur në mbledhjen e gjashtë të rregullt të KPF-së për këtë vit! Desha të ju njoftoj se shumicën e aktet që i kemi miratuar kanë marr ligjshmërinë nga ana e MAPL-së, përveç një vendimit ende nuk e kemi pranuar konfirmimin e ligjshmërisë dhe një vendimi nga seanca e me hershem. A ka dikush jashtë rendit të ditës ju lutem?

znj.Liridona Bislimi: Kisha pas dy çështje me i diskutu, nëse ka mundësi natyrisht me mirëkuptimin e juve. Nëse ka mundësi si pikë të rendit të ditës me fut si pikë e 8-të, ky raporti i auditimit, se nuk na ka ardh te pasqyrat vjetore financiare për periudhën 2022, është mirë me u diskutu në kuvend tjetër. Çka na ka interesu si lëvizje tek subvencionet që janë bë për najllan, ka pas shumë ankesa prej qytetarëve, se najloni ka qenë shumë jo kualitativ. Domethanë në momentin e parë që është kap nëpër dorë, po na intereson me pas si një lloj informate sa ka kushtu ky najlon. Normalisht edhe përfituesit edhe pse është kaq jo kualitativ, kaq i dobët se kemi pas shumë ankesa.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Te çështja e auditimit, nuk e kemi diskutu hala qe e kemi edhe ne planin e kuvendit, besoj në seancën e ardhshme.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Unë besoj se raporti i auditorit duhet me ardh s'bashku me planin e veprimit çka është punu dhe çka kemi me punu për mënjanimin e tyre. Unë besoj do ti kesh edhe këta kryesus në shtator, nuk është problem po nuk ka kuptim me te ardh raporti i auditimit pa planin e veprimit, se në momentin që janë ato rekomandimet, duhet me i ndërmarr masat cilat mujm me i mënjanu dhe te cilat nuk mujm me i mënjanu. Çështja e folive. edhe tek ne kemi pas ankesa të panumërta. Unë kam bisedu me drejtorin, momentin e parë do ta kesh informacionin ja me gojë ja me shkrim. Sipas informacioneve që kam, drejtori ka vnu kontakt me kontraktuesin, i cili e ka pas edhe ai e ka pranuar që ka diçka ne at najlon. Prodhuesi nuk e ka qit një elementë i cili ka ardh deri te prishja, sen që unë se marr vesh, unë sipas drejtorit të bujqësisë kontraktuesi do të bien foli të re për të gjithë, por megjithatë me detajisht pas takimit zakonisht i thirri drejtorët dhe i tregoj cilat çështje janë ngrit dhe për cilat çështje duhet me u përgatit për to. Sivjet kanë qenë kritere më të ndryshme, jem në mesin e 5 komunave ne nivel Kosove që jena të kualifikuam të tjerat në bazë të kritereve e kanë humb për grand performacë. Informacionet e para i kam këto, po mos i merr krejt të sakta deri sa t'i kam zyrtarisht. Veç jem në mesin e 5 komunave të cilat jemi kualifiku në top 5 më të mirë.

z.Ramadan Deliu: Unë e kam një pyetje për qeto punë që janë tu ba: kush është tu i kontrollu qeto kompani?

Më së pari në Kabash herë punojnë 2 argat herë 3 argat. Nuk është tu punu siç duhet. A keni marr diçka, a keni bisedu me kompani, a kush është përgjegjës për kompaninë?

z.Illir Zuka: Përsëritet për të gjithë te pranishmit! Unë e kam një shqetësim. Në 2020 kanë kalu rrugët për asfaltim dy lagje në Pozheran, rruga "Ibrahim Pira", te lagjja e "Ballancëve" edhe një është te "Alidemtë". Domethanë 2020/2021. S'po lyp me më kthy përgjigje. Pres në kuvend nënkryetar me ma konfirmu, kanë ardh inxhinierat bashkë me ta para 2 vite, me rrafshues i kanë qit pak zall, kurrë ma s'janë ardh. Kam provu me fol me ata çka është dashtë, sun kam gjet zgjidhje. Gjithashtu edhe te lagjja "Hoxha" në Sllatinë, edhe ata e kanë të njëjtin shqetësim. U kanë në projekt dhe nuk është asfaltu. Gjithashtu është edhe lagjja "Demir dhe Halabaku", ajo lagje ka shumë problem me qentë endacak. Unë e kam njoftu edhe drejtorin me shkrim dhe me fotografi, që mi kanë qu, kanë problem me dal prej shpisë ajo rruga që e lidh Pozheranin me Vitinë. Në mëngjes njeri është qu me shku në punë, s'ka mujt me shku prej qenve qe ja kanë rretheku aborrin. E kam njoftu drejtorin, ma ka lan seen, s'ka pas as kohë me ma kthy. Nuk po pres me ma kthy përgjigjen tash, po në kuvend. Duhet me ndërmarr diçka sa i përket për shkollën ne Pozheran dhe stadiumin s'jena tu fol, me se po shihet që s'është tu ba kurgja. Kena vendos mos me fol, e kena lanë në dorë të Zotit. Një iniciativë ke shumë e mirë e shoqërive civile, qe i përgëzoza qe e majtën një takim edhe i thirra për mos me politizu, mos me thanë qe po organizoni mbledhje e mos me dal pjesa e Vetëvendosjes ose ai aty. Merrni ju gjithçka çka të keni nevojë, më keni përkrah. E majtën një takim, e qiten në Plus Televizion dhe me qaq u mbyll. Kështu që, skena zgjidhje. Kena majt ymyt, që pe përfundojnë stadiumin, po ai edhe stadiumin e la kështu që s'kam diçka tjetër. Ata shumica janë diasporë, në momentin që kanë ardh me kanë thirr krejt, bile më thanë çdo vjet të njëjtat rrena po naj shet. Thuj s'po naj shtron, vet kemi me shtru, se kur kanë ardh para do vjete me bagera, ata i qiten do soka, ata hynën brenda, bagerat hecen, kurrë ma s'u shktru.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Rafiz Shabiu është mbikëqyrës. Megjithatë sipas të gjitha gjasave, ata nuk po e pranojnë, po unë po muj me kuptu që ata kanë mungesë të punëtorëve. Tash megjithatë komunës dhe fshatit nuk i intereson, po ata e paraqesin te rasti i juve. E kemi edhe për Sllatinë, edhe për Devajë, edhe për Letnicë, që unë kam pas vet takim edhe i kam than pse i ke nis krejt, nise njërën. Njëherë shkon rrafshimi, njëherë qysh i kanë ata. Po sipas gjitha gjasave, siç kam konstatu, ata kanë mungesë të punëtorëve Ilir. Sipas informacioneve që kam, që besoj ka me qenë i saktë, dy rrugët në Pozheran, kur është shpall tenderi është shpall me njësi dhe janë hargju metrat katror, por megjithatë unë do të kujdesem. Për informata më të sakta, shkollën dhe stadiumin, megjithatë ju keni pushu, po ne s'kemi pushu asnjë ditë. Unë po vij nga takimet të cilat po bëjnë përpjekje te vazhdueshme, ne mesin e tyre edhe unë e kam thirr mbikëqyrësin dhe a e din cilën e kam marr përgjigje. Është ndërru drejtori i financave, se me te kontaktojsha, zakonisht para 7/8 muaje e kanë largu nga puna dhe më thotë bëni presion të vazhdueshëm. Aty s'ka çka thotë tjetër dhe ne presionin nuk jem tu e nal. Edhe drejtoreshën e kem qu, e ka nënshkru edhe një letër e kanë dërgu në shumë çështje nuk jem tu nal, po gjendja nuk ka nis. Në këtë drejtim kam pas takim te progresit. Sa i përket stadiumit, punëkryesi, unë jam një prej atyre qe merren me politikë, po shumë drejtë e thamë. A e din çka më ka thanë, shtinem në listë të zezë, ndërprema, nuk kam çka baj, se materiali ka hyp shumë.

z.Illir Zuka: Janë tu lujt fmia me gumë, tu ba hajgare fmia me gumë, qe ka me u shtru stadiumi, se ata fëmi janë, nuk e dinë ata, e kan lan qeshtu për qëllime të caktume. E di edhe unë edhe ti, është i njëjti njeri që është tu i ba nëpër projekte tjera, po të kish ardh Fadili, unë e pata njet me i thanë me qëllime te caktume, se është tu ba ajo punë.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Për çështje të gumës, unë thirri sot dhe baj presion, se ma ka dhanë fjalën prej takimit qe këna dal nuk kem lshu pe, edhe për tribuna, po megjithatë shumica e kompanive kanë thanë të njëjtën për shkak të ngritjes së çmimeve te cilën smujn me punu me humbje. A do të arrin me zgjedh këtë problemin e shkollës nuk e di përpjekjet janë te vazhdueshme takime dhe drejtoresha ka qenë po ajo çka është me brengosëse, shumica e sekretarëve permanent as përgjigje s'po na kthejnë gjendja është kjo. Edhe ti paske thanë të shoqërisë civile jam i pari edhe unë mas teje nëse s'më le me dal i pari, bile i dyti dal sa i përket shkollës të stadiumit jem pak skeptik, se kem ba një zgjidhje tjetër tash momentalisht ne krejt territorin e Vitisë një prioritet qe e qes është

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, për këtë mbledhje kemi këtë:

R e n d i t e

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e Komitetit për Politikë dhe Financa.**
- 2. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën Janar - Qershor 2022.**
- 3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës të Komitetit për Planifikim, Rregullim të Hapësirave dhe Mbrojtjen e Mjedisit për vitin 2022.**
- 4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2023.**
- 5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik draft rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2023.**
- 6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendim, me numër të Protokollit 01-110/05-216 të datës 04.03.2019.**
- 7. Informatë për realizimin e planit të prokurimit për gjashtëmujorin e vitit 2022.**

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e peste e Komitetit për Politikë dhe Financa**

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim për miratim. Nga të gjithë u miratu procesverbali.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi:

- 2. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën Janar - Qershor 2022**

z.Besnik Imeri, drejtor i financave: Përshëndetje për të gjithë! Bazuar në ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës, para jush paraqes pasqyrat financiare të organizatës sonë buxhetore për periudhë janar qershor 2022, përfshirë të hyrat vetanake të realizuara si dhe shpenzimet buxhetore për të gjitha kategoritë gjatë periudhës Janar-Qershor 2022 janë realizuar gjithsej të hyrat vetanake në vlerë prej 445 mijë e 843 euro e 82 cent. Shkalla e inkasimit është 45.13%, ndërsa krahasuar me të hyrat për periudhën Janar-Qershor të vitit 2021, të hyrat këtë vit janë më të ulëta për 50 mijë e 300 euro e 50 cent. Buxheti i alukuar për këtë periudhë të vitit 2022 nga fondet burimore, grandit qeveritar, të hyrat vetanake dhe donacionet janë 7 milion e 79 mijë e 287 euro e 75 cent, ndërsa shpenzimet janë 6 milion e 46 mijë e 550 euro e 74 cent. Shkalla e ekzekutimit të buxhetit për këtë periudhë është 85.41% në krahasim me alukimet për të gjitha programet ekonomike. Tek kompensimi i të punësuarve apo pagave, mëditje, shkalla e ekzekutimit të buxhetit është 99.32% mallrat dhe shërbime në përqindje 75.02% subvencione, 83.95% komunal, 77.28% shpenzime kapitale, 61.05% buxheti për vitin 2022 i alukuar totali është 13 milion e 348 mijë e 531 euro e 63 cent për vitin 2022, ndërsa për 6 mujorin e parë të këtij viti është 7 milion e 79 mijë e 287 euro e 75 cent. Totali i shpenzimeve nga këto aludime është 6 milion e 46 mijë e 558 euro e 74 cent, duke kaluar në kategori. Shpenzime totale të Zyrës së Kryetarit janë 279 mijë e 222 euro e 95 cent apo 79.05% është ekzekutua buxheti në Zyrën e Kryetarit në administratë dhe personel 121 mijë e 285 euro e 05 cent apo në përqindje 94.84% në Drejtorinë e Inspeksionit kemi 41 mijë e 914 euro e 80 cent apo 96.82% tek Zyra e Kuvendit Komunal 45 mijë e 108 euro e 37 cent apo 91.47% tek Drejtoria për Buxhet dhe Financa 1 milion e 58 mijë e 939 euro e 41 cent apo 62.43% tek Drejtoria e Shërbimeve Publike e Mbrojtje Civile dhe Emergjencia kemi shpenzime të buxhetit në vlerën prej 435 mi e 714 euro e 28 cent apo 87.91%. Të hyrat buxhetore komunale vetanake të planifikuara dhe të realizuara për periudhën Janar-Qershor 2022, të hyrat të planifikuara për vitin 2022 janë 987 mijë e 868 euro planifikimi 6-mujor është 482 mijë e 418 euro, ndërsa periudhat e realizuar janë 445 mijë e 843 euro e 88 cent. Diferenca nga viti në vit është 542 mijë e 24 euro e 12 cent. Përqindja në 6-mujorin e parë arritjes të

hyrave është 92.42 %, ndersha vjetore është 45.13%. Krahasimi i te hyrave vetanake ne vitin 2021 dhe 2022 për këtë periudhën e njëjti Janar-Qershor kemi dallime në të gjitha, po ajo qe besoj ju intereson më së shumti është tatimi në pronë, pasi që është edhe hyrja kryesore vetanake e komunës sonë, tatim në pronë në këtë periudhë ne vitin 2021 kanë qenë 249 mijë e 875 euro e 70 cent, ndërsa në vitin 2022 për këtë periudhë kanë qenë 288 mijë e 534 euro e 02 dallimi eshët 61 mijë e 345 euro e 68 cent krahasimi ne mes 2021 dhe 2022 është 75.45% në total të hyrat vetanake kemi me pak për 50 mijë e 320 euro e 50 cent. Shpresojmë qe këto të hyra me ardhjen e mërgatës sidomos ne tatim në pronë do të mbulohen. Kemi prit që ka me pas ma pak të hyra në tatimin në pronë për shkak të heqjes së kufizimeve, por puna e punëtorëve të tatimit në pronë jo vetëm në tatim pronë, po edhe e kemi diskutu që edhe me familjar edhe kudo qe je me promovu tatimin në pronë, pasi që është e hyra kryesore komunale dhe të cilën mujm me përdor pa na diktua nga fondi burimor qeveritar, e kemi pastaj përshkrimin e investimeve pagesat buxhetore dhe kontraktor të cilët janë paguar. Prezantimi i investimeve sipas burimeve të financimit për këtë periudhë grandi qeveritar merr pjesë me 95.62%, te hyrat vetanake me 4.34%, pastaj kemi përsëri te përsëritura pagat për mëditje te marra dhe shërbime te paraqitura ne mënyrë grafike. Krahasimi i shpenzimeve nga viti 2021 ne vitin 2022 kemi te totali i pagave 90 mijë e 885 euro e 19 cent, kemi ekzekutim të pagesave me të mëdha tek totali i shërbimeve mallrave dhe komunalit kemi 329 mijë e 771.56 cent më shumë kemi 112 mijë e 97 euro e 80 cent, ndërsa te investimi kapitali kemi më të lartë për 192 mijë e 428 euro e 21 cent. Kjo ishte një përmbledhje e pasqyrave.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Te çështja e këtyre prezantimeve te investimet kapitale, a ka pjesë të pagume edhe të punëve të vitit të kalum apo janë veç punëve të sivjetit. A e din, na e dimë që ka pas ngecje sidomos te trotuari, se pe dimë për çka tash janë tu tentu kompanitë mi rrit kontratat për shkak të kërkesës qe e kanë një zhagjitje të punës, është në nivel të Kosovës qe bizneset janë tu e prit këtë në bazë të punëve që janë ba te puna trotuareve. E dimë që kjo vlerë është problem sivjet se nuk është punu.

z.Besnik Imeri, drejtor i financave: Po ka edhe te vitit të kalum.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Deshta me u lidh edhe te krahasimi i leximeve. Më herët e kemi pas edhe përherë na ka ardh si forma e tabelës, faqe 26 që e ki në mes të vitit 2021/2022, e kemi pas edhe një rubrikë njëherë edhe Basra kanë qenë drejtor, e patën jek këta e kena reagu edhe menjëherë e kanë fut se këtu është kanë dallimi. Domethanë mjetet që për shkak janë pagu 2021 janë pagu ne 2022, i kena pas këtu që është një lehtësim për ty, se tash qe me vjen mu një ndryshim i madh, përshembull qe marrmi shërbimet kontraktuese e tjera 41 mijë euro 6-mujori i vitit kalum, tash 83 mijë euro 6-mujori i këtij viti. Tash diferenca është qaq e madhe, ne e dimë qe një pjesë e madhe janë te vitit te kalum. Ne e dimë tash me pas qet rubrikën ne mes, domethanë kalon pa pyetje, se ne e dimë qe një pjesë e fundit, sidomos Nëntor-Dhjetor po mesin pa u pagu. Kjo ta leton edhe ty po edhe neve si informatë e kanë pas jek njëherë, po tani e kemi kthy.

z.Illir Zuka: Po e nisi me ata, se herën e parë e patëm ngrit si shqetësim, domethanë grumbullimin e mjeteve e pash që është ba një punë e mirë. Ju përshëndes ty edhe punëtorët, se me siguri është marr edhe dikush tjetër, po ty të bjen me të përshëndet, se je drejtor i drejtorisë, se begi mirë kish të hyrat edhe duke llogaritë se këtë muaj kemi edhe diasporën këtu, llogaritë se do te jenë shumë mirë. Një shqetësim kam, se kur është aluku buxheti, i pash që do drejtori kanë met begi mbrapa me pagesa, masi e kanë pas buxhetin e alukum është kanë dashtë me kry pagesën e jo me met. Te Drejtoria e Kulturës e pas 73% qe e kan hargju buxhetin a kur e dimë se tash është faza finale qe tash me fillu çdo aktivitet fizik sene, ajo s'ka marr subvencion asnjë klub. Shqetësim qe është dashtë me ngrit shumë më herët me u merr krejt me ta. Te shëndetësia nënkryetar, te ti po drejtona, kam has gjatë kësaj jave me ka ra me shku disa herë në ambulancë se u deshtë me ngrit aty domethanë si pyetje jashtë rendit të ditës po me ndërmarr diçka, se asnjë pacient s'ka pas shancë me marr infuzionin pa i kup nja 3 kësi çka i thonë kanila gjatë marrjes së infuzionit. Këtu ka pas edhe 10% hapësirë që si kanë shpenzu e qe i kanë të alukume. Është shqetësim i mjekeve atyre motrave medicinale teknike tash e pash këtu te shëndetësia është mirë me u marr me ta. Kryesueses nuk kam diçka ma shumë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Dine se te alukimi gjitha senet qe janë ba ne fund të Qershorit ato nuk hinë asnjë veç që janë pagu ata, banvaki janë shpenzu të gjitha qind për qind.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Tri drejtori të cilët janë më të dobëta është kultura, bujqësia, shëndetësia. E dini se na e këna alunu thirrjen dhe e këna rishpall. Tash nuk e kena ba na me dashje, po ka vendos një komision i cili ka has në parregullsi edhe komisioni i shkalles së parë e ka anulë dhe e ka rishpall tash. Është formu komisioni, besoj se kryhet. Te çështja e bujqësisë, me sezona unë pash dje thirrje për serra, multikultivator etj, etj. Unë besoj se kanë me mbyll suksesshëm vitin kalanderit, tash e kanë mbyll këtë 6-mujorin, domethënë është me ransi ne procedurë, besoj qe kanë me u kry. Unë rrezikun e shohë pak më të madh, edhe pse jam në ekzekutiv te investimet kapitale për shkak se dikun në të gjitha tenderët te cilat janë dhanë kanë ankesa. Formimi OSHP-së me vonesë dhe ndoshta kanë me na shti në kohë pa kohë, që banvaki ka me te qu ne mjete, këtë breng e kam, se këto tjerat besoj suksesshëm kemi me i kry.

z.Besnik Imeri, drejtor i financave: Ilir, faleminderit për ato, ndërsa për këto qe e përmendët shëndetësinë, e këto kuvendi ju kam than edhe drejtorëve, un jam për korrektësi të pasqyrave.

z.Ramadan Deliu: Dashta pak me u lidh, merita pa merita. Thuj kanë dashtë populli me pagu e kanë pagu, se s'ke marr kurgja për me i shti me pagu.

znj.Liridona Bislimi: Sa i përket pasqyrave financiare për vitin 2022, si përfaqësuese e opozitës edhe ne kemi analizu materialin dhe kemi disa kërkesa. Atëherë drejtor po kaloj te faqja numër 3, tek totali i pagave, 13210 shpenzimet e rrymës. Na intereson me ditë qekjo shifër a është ngritur për shkak të rritjes së çmimit, për çka ka ndodh, për çfarë arsye. Tek shpenzimet e telefonisë fikse, kemi vërejtun qe është një ngritje shumë e madhe, tu e marr parasysh qe sot shumicën e komunikimit e bëjmë përmes rrjeteve te cilat janë pa pagesë, përmes mesengerit, viberit e tjerave. Po na vyen me ditë, a kanë borxhe të reja që janë bart, apo ka ka ardh kjo shifër kaq e madhe. Tek 13430 shërbime te ndryshe shëndetësore. Si zakonisht kërkojmë sqarim me pas te 13470 shërbimet kontraktuese tjera, tek shpenzimet për anëtarësim. Ne e dimë se kjo sfidë ka qenë me herët, pse është rrit kostoja kaq shumë dhe te mobilet besoj qe janë furnizimet me se shumti neper shkolla zakonisht e keni këtë arsyetim e po na nevojitet me dit se cilat shkolla janë investu pajisjet tjera po besoj qe e pasna si përgjigje, se kemi kerku sqarim furnizim me lend djegse dru 13760: a janë vetëm për shkolla apo është për te gjitha njësit buxhetore? Kjo është ajo qe me intereson me ditë. 14020 mirëmbajtja e ndërtesave, tash po na vyen me ditë a është kontrata me kompani private apo është komplet kontrata deri ne fund të këtij viti. Tek mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjet, po besoj qe ma ke ofru po sidomos mu ka nevoj sqarim. Te faqja numër 5, tek shpenzimet e Zyrës së Kryetarit, 13460 shërbimet kontraktuese tjera. Na është nevojit sqarim 35 mijë euro, shuma që po diskutojmë. Te administrata edhe personeli, kemi pa që janë pajisje tjera 7 mijë euro, cilat janë ato pajisje. Tek faqe numër 7, totali i pagave te pajisje, trafiku 11 mijë euro, na intereson me ditë se në cilat. Atëherë te kjo pjesa nevojitet me dit te cilat lokalitete edhe a ka qenë pajisje horizontale apo vertikale. Tek faqja numër 9, shërbimet kontraktuese tjera 13460, na nevojitet sa punëtorë janë me kontratë për këtë periudhë dhe te pajisjet tjera. Po besoj qe e kam, po nuk e kam ditë që i ke përgatit. Te faqja numër 10, te shpenzimet e rrymës. Qysh e thash edhe ne fillim, te rritja 65 mijë euro, kemi dyshime për çka ka ndodh kjo shumë kaq e madhe, shërbimet tjera 13460 na vyen një detaj i detajizum. Nëse ki mundësi me ofru në kuvend 23 mijë euro është çmimi. Mirëmbajtja e autorrugëve lokale, edhe kjo na nevojitet si sqarim edhe mirëmbajtja rutinë.

z.Besnik Imeri, drejtor i financave: Edhe diçka kisha dashtë, s'po du me përsërit veten, po pyetjet qe i bana, shumicën po e përsëris edhe një herë. Unë jam për korrektësi te shpenzimet hyrje dalje për çka ndodh nëpër drejtori, pse i pagun, ku i pagun ato janë përgjegjësi e drejtorive. Unë muj me dal mi mbledh po nuk e di tana cila punë është e jemja.

znj.Liridona Bislimi: Tash na jena te analizu raportin. Unë për me ja kerku drejtorive përkatëse ju është dashtë me mi sjellë drejtoritë përkatëse. Tek bujqit dhe zhvillim rural, kjo 92.53%, tek subvencionet na vyen një sqarim se si janë shpërnda mjetet. Tek faqja 15, po besoj qe i pasna shërbimet kontraktuese, shërbimet tjera. Tek kultura, rini dhe sport, te subvencionet është vetëm 3.75%, është një përqindje shumë e ulët kjo.

Besoj se duhet me një përgjigje. Edhe nënkryetar: a ka rregullore për ndarje të subvencioneve në Komunën tonë.

Nënkryetari, z.Hasan Aliu: Po është rregullore e cila vlen për krejt komunat, nuk e përjashton edhe Vitinë, është e nivelit qendror.

znj.Liridona Bislimi: Te faqe 18, shërbimet kontraktues tjera. Ata punëtor me kontratë mbi vepër, për këtë periudhë mujore sa është kostoja 6-mujore e përfitimit nga vendimet gjyqësore të mësimdhënësve për kontratën kolektive? Domethënë për këtë 6-mujor, tek faqja 20, në fund e kemi shkallen e realizimit duke u bazuar në planifikimin vjetor, e cila është 45.13%, që i bjen se 50 % nuk është realizu. Nëse e mbledhim totalin, 482 mijë minus 445, është minus 37 mijë. Te faqja 22, diçka që na ka ra ne sy, është për periudhën Janar-Qershor 2021. Nuk ka pasur të hyra fare nga donacionet. Ne e dimë që kryetari ynë zakonisht i përmend. Janë edhe disa tjera, po në rregull është. Faleminderit shumë!

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ne momentin që e kemi materialin, na mujna mi fol krejt. Nëse ne e flasim sot analizimin ose shpenzimet, planifikimet, domethënë mas keqti dalmi kuvendi, se ne i kemi 27 mijë euro, e 27 mijë euro, tash me ato çka janë bart nuk i kemi hargjit as 1 mijë euro. Na dalmi shumë keq, po tash ne shembull e dimë që e kena qu një vendim me naj kthy prej ministrisë, ja bajna kërkesën Zyrës së Prokurimit me ju marrë laptopa për këshilltar, i harxhojmë qeto pare krejt këtu me një veprim me një punë që e banë ato realizohet, mirëpo te financat, te raportit në bazë asaj që është praktikë, e që e di hala ma mirë pjesën e mjeteve që janë te na për kuvend. Po flas, drejtori as nuk e di çka i shpenzojmë, ne i bëjmë 4/5 nënshkrime deri sa të shkon për pagesë drejtori, veç shkon e pagun, nuk është përgjegjësi e ti çka kena ba na, përgjegjësi e tij është mi pagu qato. Nëse dikujt i vyen informata na ku kena shpenzu, duhet me na u bë një kërkesë neve edhe ne me nxjerr saktësisht ku janë informatat e sakta, çka janë te drejtorisë ato janë çështje. Ne vet te shenjat horizontale vertikale duhet me ja ba inspeksionit. Ata e dinë ku i kanë vnu ato sheja për me ditë punën ku e kanë vnu, ndërsa sa kanë kushtu mundet me ditë drejtori, e ka për detyrë.

Nënkryetari, z.Hasan Aliu: Unë i kam zgjedh, se për shkak se e kam pas mungesë drejtorin dje. Do të bëjë përpjekje. Liridonë, ke shtu edhe disa te tjera të cilat përafërsisht për shkak te përvojës dhe janë sene te përsëritshme, që i përsëritni. Kam ba përpjekje, i kam dhanë detyrë edhe atij punëtorit atje si analist i buxhetit, mi ka sjellë, megjithatë ato te cilat nuk i kam i evidenton drejtori, i merr dhe i sjellim në kuvend. Çështjen e parë të cilën e ngrite, kodi 13430 shërbime të ndryshme shëndetësore. Pagesa për institutin publik për investim në punë dhe përkujdesje shtëpiake, Karitasi, janë këto. Shërbime shtypi, jo marketing që më ka interesu edhe mu. E ki një të dhënë, ishin këto që i printojnë, të cilat i kanë marr në nivel qendror, kompetent. Shërbime kontraktuese tjera, kontrata për shërbime te veçanta, e ki shifrën 43 mijë e diçka. Këtu bin përveç kontrata, bin asgjësimi i mbeturinave në shëndetësi, i kam nxjerr me shifër 2895, bashkëfinancim me Karitas Kosovën për zyrën e biznesit 2895 shërbime kontraktuese tjera, trajtim i qenve endacak, që e kena pas një kontratë 9715 dhe pagesa për institutin për inspektim në punë 60 euro. Domethënë kam ba përpjekje mi nxjerr kështu detalisht shpenzimet për anëtarësim që pyete që u rrit. E ki edhe asociacionin e komunave dhe e ki AZHR-në e lindjes, të cilat janë shumë. 8548 euro mobile, furnizim me inventar. Tash i shiqoj atje çka i kemi pajisje tjera, furnizim për te gjitha, po programi që e ngrite një çështje që është pagesa për projekte, mirëmbajta e ndriçimit publik dhe dekorimi i qytetit, furnizim për zyre, furnizim në arsim, nëpër shkolla, e ki furnizim me maska dhe dezinfektues nëpër krejt shkollat, që shifra kap 6485 euro. Furnizim për zyre nëpër drejtori 1413 dhe furnizim për shëndetësi 4895 euro. Këtu i kemi edhe detajet, tani ku ke pyet shërbime të ndryshme shëndetësore, e ki edhe me fakturë kur ja kemi qit për të gjitha që kap shifrën 117 mijë. Ndoshta unë jam në gjendje me ti lexu, kjo është e shërbimeve shtypi, jo marketing. Shërbime kontraktuese tjera të cilët i kemi edhe punëtorët me kontrata te shërbimeve te veçanta, numrin e tyre muj me ta nxjerr me ta dhanë po bajn pjesë përveç tyre edhe administrata tatimore, trust pensional. të gjitha që bin po e kërkove numrin në seancë te kuvendit, ta bi, ka bukur shumë, këta e dinë qytetarët AZHR lindje 1500 euro, Asociacioni i Komunave të Kosovës 7048 euro. e çështja e mobileve detalisht ku jan shku këtu i kemi vetëm për zyre 1490 mobile 3175 e tjera, pajisje tjera edhe këtu rregullimi i ventilimit ngrohjes për objektin e ri te komunës, pajisje është

përfutuese një kompani e Selajdin Fetahut që e kap shumën 3994, 48861. Për çdo send e ki fakturën të cilën mundesh me shku me kqyrë me numër edhe kjo për furnizim për zyre e ki. Kam ba përpjekje për ato pyetje të cilat janë përsëritë ato tjerat. Çështjen e rrymës që nuk e kam nxjerr, e ki për obligim me nxjerr drejtor dhe me shiku a ka qenë borxh i bartur i viti 2021 ne 2022 apo kemi harxhu me shumë dhe është hera e dytë edhe ne 3-mujor e kanë ngrit çështjen e telefonisë fikse, merrni telefonitë fikse sa numra janë funksional ne kreyt komunën edhe shkollën, se edhe për shkollë paguhen.

z.Besnik Imeri, drejtor i financave: Deshta me fol për telefon, se po përsëritet zyrtaret. As zyrtar komunal administratës, as organizatat s'munesh me i thirr viber, as whatsapp. Më ka ndodh që i kam thirr me mobil temin nuk ma ka qel, kur e kam thirr me telefon fiks ma kanë qel. Kjo është zyrtare edhe rrjetin e kemi me telefonin mobile përmes postes.

Nënkryetari, z.Hasan Aliu: Drejtor, ti i nxjerr numrat sa janë funksional në Komunën e Vitisë, sa paguhen nga buxheti i Komunës së Vitisë edhe kjo punë kryhet.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Liridonë, tash për këtë zyre e kemi blej një nxemje, se s'i lshojshim këto masdite u bajke ftoftë. Kjo është ble 40 euro. E kemi ba kërkesën me Fatlumin, nuk ka pas ku me hi edhe i shehë të pjesa jon e kuvendit, pajisje tjera 40 euro, se s'ka të parapamë me kontrata, se për çdo sen sun ban kod.

znj.Liridona Bislimi: Nëse kisha mujt veç diçka me shtu. Është hera e parë që pe kena njëfarë ndryshimi te këtyre informatave te këtij raporti. Çka me intereson me ditë drejtor, ta kam ba një pyetje, besoj që e din për çka është fjala edhe kam prit hapësirë me ma kthy përgjigjen, mirëpo u vanu 2 muj gati 3 qe se kam marr përgjigjen. Edhe një tjetër pyetje ja kam ba Zyrës së Kryetarit, i ka ma shumë se 1 muj, prapë kam ba kërkesë po nuk është kthy përgjigja. Zyra për Informim, Mustafa ma ka kthy përgjigjen që është në pushim edhe nuk e di tash qysh me vepru prej Zyrës së Kryetarit që i ka lshu do mjete. Tash a me ju drejtu agjencisë për informim pse nuk kam marr përgjigje.

Nënkryetari, z.Hasan Aliu: Sa i përket aspektit informativ, Mustafën e zëvendëson Agroni edhe Blerina. Si person për qasje në dokumente zyrtare, nuk i kemi lan zëvendësim pikërisht për këtë. Prite kur te kthehet për te parë qe po thu. Besoj qe përgjigjen e ke marr.

znj.Liridona Bislimi: Afati ka kalu, tash unë mos me i hi kësaj pune përmes agjencisë, përgjigje nuk kam marr, ju keni mujt me me thanë mu, po kërkojmë specifikim. Zakonisht ma keni kthy shpesh këtë përgjigje edhe pse pyetja ka qenë shumë e qartë, nuk kam marr asnjë përgjigje, mandej kur ka kalu afati prita edhe 3-4 ditë, i keni pas do probleme me web faqe, u banën 3 javë që e kam ba atë pyetje. E bana edhe njëherë, Mustafa ma kthej përgjigjen që jam në pushim. Qata thash me mirëkuptim te juvin qysh me vepru, se kur e kam ba pyetjen, Mustafa ka qenë taman tu punu.

Nënkryetari, z.Hasan Aliu: Unë po kontaktoj, e shënova qetu edhe në kuvend individualisht ta jap përgjigjen, për shkak se derisa te kthehet Mustafa, ta shof së pari kërkesën tanë dhe duhet me bisedu me Mustafën, se ata janë edhe te trajnum lidhur me atë se me një trajnim kam edhe unë s'bashku me Mustafën se naj kanë dhanë edhe ligjin për sa ditë, cilat janë format dhe mënyrat.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Deshta veç një pyetje të vogël drejtor, që e diskutum çështjen e planifikimit edhe ishte temë kjo te tatimi në pronë. Edhe tatimi në tokë është një kod buxhetor, a nuk ndahet, se atje u kërkojnë se, qekjo mu kanë e dame, se u pa që kjo është me një kod. Domethanë tatimi në pronë dhe në tokë shkon me një kod. A jeni, me ngritje te dorës, që kjo pikë të shkon për kuvend. Të gjithë janë pro. faleminderit shumë!

Pika e dytë e rendit te ditës, me kërkesën e Zyrës së Prokurimit. A jeni qe ta ndryshojmë agjendën. Pika e fundit të del pikë e dytë.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi:

2. Informatë për realizimin e planit të prokurimit për gjashtëmujorin e vitit 2022

Shef i Zyrës së Prokurimit, z.Fadil Abazi bëri prezantimin e projekti Janar Qershor të vitit 2022. në këto informata i kemi mbledh të gjitha kriteret e zhvilluara për zhvillimin e punës, gjegjësisht investimeve kapitale që janë të domosdoshme për komunën.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Para se me dhanë fjalën, e kam vërejt zoti Fadil, që tashti kontratat nuk janë të publikume ne web faqe, se kur të janë të publikume e kemi me të lehtë informimin.

z.Illir Zuka: Shqetësimi me i madh është që, e dimë shumë projekte që janë blloku janë në ngjarje. A është aktive tash OSHP-ja për shkak mos mi vanu këto procedura, se këto janë projekte te mëdhaja. Një punë jashtëzakonisht e mirë është bë për ventilim te komuna e re me 3999 euro. E pata unë veç një shqetësim. A ka mundësi me ditë, sa është ba një metër dru, se unë kam dal në Pozheran i kam kqyr, ai kqyr naj kush këto dru?

Shef i Zyrës së Prokurimit, z.Fadil Abazi: Asnjë përgjegjësi nuk e ka Zyra e Prokurimit, gjithçka shkon përmes njësisë, kërkesës dhe menaxherit të kontratës. Ata e bëjnë edhe një komision nëpër shkolla, ata e bëjnë pranimin. Këtu hyn bartja, hyn edhe në prerje 51 euro, i bjen komplet qysh kanë hyp çmimet. Mu kanë pas dokë shtrejtë, se s'kemi pas zgjidhje edhe nuk ka zgjidhje, nuk ka oferta për dru shumë, është veç një ofertë.

znj.Liridona Bislimi: Unë kam disa informacione, nëse kisha mujt me i pas te pika e parë, furnizimi me derivate për të gjitha njësitë shpenzuese. Ne e dimë që në muajin Janar me muajin Qershor dallon çmimi i naftës. Tash a është bërë diferenca e çmimit për muajin Janar Qershor dhe qysh është vendos?

Shef i Zyrës se Prokurimit, z.Fadil Abazi: Jo, kjo nuk shkon me ata me çmime, kjo shkon me atë. Ne e caktojmë atë premiumin e fitimit, ndërsa çdo muaj operatori ekonomik e sjellë zyrtare. Nëse është 1.50 në berzë, ajo ja shton edhe 10 cent te vetat. Çdo herë shkojmë me berzë, se nëse shkojmë qashtu qysh po thu ti, tash qysh ndërron tregu. Berza është zyrtare, ajo vjen qeqaq është ne berzë, sa është ne berzë dhe faturohet faktura mujore me premium dhe ju qitet vetëm vlëra përfituese, sepse nuk e dimë sa harxhojmë, në fund dihet, është kontrata edhe pse skemi harxhu me shumë se 50-60 mijë euro, po qeshtu është planifikimi.

znj.Liridona Bislimi: Te pika e gjashtë, shërbimet e kujdesit social dhe shëndetësor shtëpiak. Këtu nëse kisha mujt me pas komplet kontratën, se është për periudhë 2-vjeçare. Nëse mundesh me ma dorëzu përmes imelles zyrtare. Te pjesa e furnizimit me dru zjarri, te gjitha njësitë shpenzuese 319 mijë. Në pasqyrat financiare është ndryshe. Tek furnizimi që janë anulë, po na vyen specifikimet e qarta.

Shef i Zyrës se Prokurimit, z.Fadil Abazi: S'ka kunkuru kerkush. Janë parapa se di 10 a 15, po kur e kanë pa shpalljen, s'ka pas interesim. Kjo letra ka shku në OSHP, edhe tash ajo koha me prit OSHP s'ka pas bord. Duhet me prit nja 40-50 ditë kur është ba puna me zgjidh problemin fara u mjell për shkak te aspektit kohor dhe është deshtu.

znj.Liridona Bislimi: Tek pika 11, furnizim me pajisje mjekësore. Po më intereson me ditë çfarë aparature nëse ka mundësi me ma dergu përmes imelles.

Shef i Zyrës së Prokurimit, z.Fadil Abazi: Po ta dërgoj, edhe kjo ka shku përmes OSHP-së, ka met qatje, kena pas problem, tash e zgjidhim këtë problem, janë një ekg edhe do tjera.

znj.Liridona Bislimi: Edhe te e 13-ta, rregullimi i ambullantave 2-vjeçare. Po më intereson me ditë, cilat ambullanta janë duke u renovu? Edhe tek e 36, më intereson me ditë, shërbimet e gjirimit, transmetimit televiziv për nevojat e Komunës së Vitisë, të kuvendit komunal. Po me intereson me ditë: a është lidh kontrata për kuvendin komunal, me cilin televizion, a është lidh me plus televizion?

Shef i Zyrës së Prokurimit, z.Fadil Abazi: Jo, kjo tash është, e kam shti në procedurë edhe njëherë, është në kontratë kornizë për 3 vjet e kanë parapa. Ka deshtu se nuk i ka plotësu kushtet qaj që ka ardh sipas ligjit, nuk i ka mbush kriteret sipas ligjit. Kjo përsëritet edhe njëherë.

z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit: Me qenë se kjo pikë e rendit të ditës nuk shkon në kuvend, nuk ka nevojë të votohet. Faleminderit shumë!

Si pikë e rendit të tretë të ditës kemi

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës të Komitetit për Planifikim, Rregullim të Hapësirave dhe Mbrojtjen e Mjedisit për vitin 2022

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi qe nuk ka për diskutim, e qes në votim për miratim. Nga të gjithë u miratu kjo pikë dhe shkon në kuvend.

Si pikë e katërt e rendit të ditës

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës se Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2023

z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi qe nuk ka për diskutim, e qes në votim për miratim. Nga të gjithë u miratu kjo pikë dhe shkon ne kuvend.

Si pikë e rendit të pestë të ditës:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik draft rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2023

z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi qe nuk ka për diskutim, e qes në votim për miratim. Nga të gjithë u miratu kjo pikë dhe shkon në kuvend.

Si pikë e gjashtë e rendit të ditës:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendim, me numër të Protokollit 01-110/05-216 të datës 04.03.2019

z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit: Këtë propozim vendim e kena me vendim te gjykatës. Qe Liridonë një kopje dhe e diskutoni atje, që vendimi i gjykatës në bazë të ministrisë. Ti je veç pjesë e kuvendit. Është fjala për përmendoren Safet Rexhepi, ministria naj ka kthy, ne nuk kemi pranë si kuvend na ka ardh keq me shfuqizu, ma mirë e këna ba ball me lan me shku në gjykatë, që kur të vjen gjykata me naj dhanë një asi dhe gjykata qe ku e ki aktvendimin qe e ka marr gjykata, veç e ka anulë vendimin parimisht, po ne detyrohemi si kuvend qe mos me pas obligim ligjor. Na detyromi me shfuqizu dhe me tutje me planin zhvillimor. Këta duhet me shti në rend dhe mu kanë i harmonizum me planin urbanistik.

z.Ramadan Deliu: Qeky vendim është për në oborr të ambulantes, e pse tash nuk vjen kadastari me ja marr atë pjesën tjetër edhe me pru në kuvend, ku është qetahi dhe këta me shfuqizu.

z.Bekim Azizi, kryesuesi i kuvendit: Ata te kadastru kanë me parapa qysh edhe me shti si plan urbanistik, si përmendore qe është edhe ajo domethënë met qashtu, mirëpo na veç e kemi vendimin e gjykatës, që na ka obligu gjykata. Shembull pika 1, aktgjykimi, aprovohet kërkesë padia e paditëses, Qeveria e Republikës së Kosovës, se qeveria e ka paditë komunën për këtë vendim prej se Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal në Prishtinë si e bazuar, edhe 2, anulohet vendimi me numër 0111005-216, i datës 04.03.2019 i te paditurës, Komuna e Vitisë dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendoset tek e paditura qeshtja kthehet prap te na qe na duhet me shfuqezu vendimi eshte anulë po na tash vendimin e gjykatës duhet me shpejtu dhe na duhet me shfuqizu vendimin e 2019-tës, nuk prek kërkush me dorë, po parimisht si qeverisje duhet me i zgjedh provat. Unë e kam si obligim me pru këtu, me pru në kuvend, kuvendi mundet me anulë. Unë s'kam përgjegjësi private si Bekim, mirëpo vendimi i gjykatës është vendim i qeverisë, është kanë punë e ndjeshme, unë mendoj që për shumë gjana nuk duhet me fol shumë.

znj.Liridona Bislimi: Po prof. Kemi qen bashkë në mandatin e kalum, ajo çka e kemi aludu në fund dul rezultat. Na çka i kemi than po përnime është çështje e ndjeshme, atëherë ka qenë, tash është edhe më shumë, ne jemi si lëvizje me qu ne kuvend, në fund kemi me dal mirë. Shpresoj që s'kemi me pas telashe as na si kuvend po as mos të dalmi keq para qytetarëve po as familjes së dëshmorit.

z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit: Mirëpo edhe një po të thamë Liridonë, shumë kena disku e kena ditë krejt që ka me u kthy i ligjshëm, po na me pas shfuqizu menjëherë, ajo sish ba, ajo u ba u kry.

z.Bekim Azizi, kryesuesi i kuvendit: A jeni që kjo pikë të shkon në kuvend, me ngritje te dorës. Të gjithë janë pro. Faleminderit shumë!

Si pikë e shtatë e rendit të ditës

7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendim, me numër të Protokollit 01-110/05-216 të datës 04.03.2019

z.Bekim Azizi, kryesuesi i kuvendit: Pas dështimit të ankandit publik që deshtum që u parapa 3 vjet, tash e paskan ba 13 vjet. Propozimin nuk ka mujt komisioni me ndërru, se do vendime na si kena caktu, domethënë edhe në kuvend kur kalon komisioni për kësi vendime ja kishim caktu afatin 3 vjeçar. Nuk ka pas obligim, unë po tregoj drejt, dje pata diskutim dhe kërkova që është ma mirë hiq mos me dhanë, mirëpo parimisht është në interes të komunës, se po paguajn 750 euro ose 720 me të ardh 720 euro në mujt është hyrje e mirë që i kanë parapa si arsyeshme. Qeshtu janë arsye.

z.Ramadan Deliu: Veç qetu nuk po e kuptoj qetahi, a duhet mu shkru këtu a komisioni shembull po ta jep rrymën, ujin, mbeturinat. A i pagun ky?

z.Bekim Azizi, kryesuesi i kuvendit: Komisioni natyrisht. Për këtë seancë e dimë edhe propozim vendimin për vizitë në Shqipëri në shtator. Domethënë ma herët kam bisedu, e kam pa që ka pëlqim. Kemi një kërkesë prej Bashkisë së Tiranës, njësi administrative dhe në bazë të kësaj kërkesë që na ka ardh me post dhe kemi mjete të mjaftueshme me bë këtë vizitë në Shqipëri.

z.Bekim Azizi, kryesuesi i kuvendit: A jeni që kjo pikë të shkon në kuvend me ngritje të dorës? Të gjithë janë pro. Faleminderit shumë!

Mbledhja përfundoi në ora 11:30

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi
